

ÇFARË JANË MASAT MBROJTËSE TË URDHËRUARA PREJ GJYKATËS?

Para paraqitjes së një dëshmitari në sallën e gjyqit të DHSK-së, gjykatësit mund të urdhërojnë masa gjyqësore të përshtatshme për mbrojtjen, sigurinë, mirëqenien fizike dhe mendore si edhe dinjitetin dhe privatësinë e atij dëshmitari apo të një personi tjetër që mund të jetë në rrezik për shkak të dhënies së dëshmisë.

DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS

P.O. Box 47
2501 CA The Hague
The Netherlands



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEĆA KOSOVA

DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS

MASAT MBROJTËSE TË URDHËRUARA PREJ GJYKATËS

www.scp-ks.org

MASAT MBROJTËSE TË URDHËRUARA PREJ GJYKATËS

Çfarë lloj masash mund të urdhërohen?

Gjykatësit mund të urdhërojnë masa mbrojtëse të ndryshme. Disa nga masat mbrojtëse më të rëndësishme janë:

Masa që mbrojnë identitetin ose vendndodhjen e dëshmitarit ose të një personi tjetër të përmendur gjatë dëshmisë:

- Fshirja e emrave dhe të dhënave identifikuese nga dokumentet;
- Caktimi i një pseudonimi (emër fiktiv) dhe mospërmendja e emrit të vërtetë të dëshmitarit;
- Mospublikimi i asnjë dokumenti me të dhëna identifikuese;
- Dhënie e dëshmisë përmes pamjes ose zërit të ndryshuar që i mundëson publikut të dëgjojë dëshminë pa mundur të identifikojë dëshmitarin;

- Dhënie e dëshmisë përmes transmetimit me dy kamera: dëshmitari mund ta shohë sallën e gjyqit dhe të pranishmit në sallë të gjyqit mund ta shohin dëshmitarin, mirëpo publiku nuk mund ta shohë dëshmitarin.
- **Seancë private:** publiku mund të shohë sallën e gjyqit, mirëpo nuk mund të dëgjojë çfarë thuhet; transmetimi publik vazhdon, por pa zë.
- **Seancë me dyer të mbyllura:** publiku nuk mund të shohë ose dëgjojë çfarë ndodh në sallën e gjyqit; ndërpritet transmetimi publik.

Masa të posaçme për dëshmitarë të *traumatizuar* ose të *cenueshëm*, si viktimat e dhunës seksuale, të moshuar ose nën 18 vjeç:

- Prania e një psikologu ose një të afërmi të ngushtë gjatë dhënies së dëshmisë;
- Transmetim me një kamerë: dëshmitari nuk mund ta shohë sallën e gjyqit, mirëpo të pranishmit në sallën e gjyqit mund ta shohin dëshmitarin; publiku nuk mund ta shohë dëshmitarin;
- Kur dëshmitari është i pranishëm në sallën e gjyqit, i akuzuari të mos mund ta shohë dëshmitarin.

Kush mund të kërkojë masa mbrojtëse dhe kur?

Për masa mbrojtëse që urdhërohen prej gjykatësve, mund të bëjnë kërkesë dëshmitarët, Prokurori i Specializuar, mbrojtësit e të akuzuarit, mbrojtësit e viktimave, si dhe Zyra Administrative e DHSK-së. Për më tepër, gjykatësit mund të vendosin vetë për masa të tilla pa kërkesë prej askujt.

Zakonisht, masat mbrojtëse urdhërohen para se dëshmitari të dëshmojë, për të mundësuar kohë në zbatimin e tyre. Sidoqoftë, në rrethana konkrete gjykatësit mund të urdhërojnë masa të tilla gjatë dhënies së dëshmisë për mbrojtjen e të dhënave të caktuara.

Shkeljet e masave mbrojtëse të urdhëruara prej gjykatës

Shkeljet e masave mbrojtëse të urdhëruara prej gjykatës çojnë në **vepra penale kundër administrimit të drejtësisë** të cilat ndëshkohen ashpërsisht në bazë të dispozitave përkatëse të Kodit Penal të Kosovës i zbatueshëm në DHSK.